

## Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e punës **Drejtor i Drejtorisë së Financës CFO** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none"><li>• Diplomë në Financë dhe Kontabilitet në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja.</li><li>• Diplomë Master dhe certifikata të njohura në Kontabilitet dhe/ose Auditim.</li><li>• Preferohet të ketë dëshmi të njohjes së gjuhës Angleze.</li></ul>
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none"><li>• Preferohet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune përkatëse në sektorin e financës.</li><li>• Preferohet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune si menaxher ose drejtues i sektorit të financës/auditit.</li><li>• Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm.</li></ul>
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none"><li>• Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.</li><li>• Njohuri të avancuara të përdorimit të sistemit kontabël Financa 5 dhe Alfa.</li><li>• Njohuri shumë të mira të Legjislacionit Fiskal dhe Doganor.</li><li>• Aftësi personale për të komunikuar dhe menaxhuar të gjitha nivelet e strukturave financiare.</li><li>• Aftësi për të vendosur objektiva dhe për të marrë vendime bazuar në analiza korrekte, në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin financiar.</li><li>• Aftësi për të planifikuar, menaxhuar, ndjekjen e detyrave dhe komunikimi në të gjitha nivelet e Shoqërisë Anonime;</li><li>• Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme;</li></ul>

- Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet.
- Nivel i lartë integriteti, besueshmërie dhe orientimi të rezultateve.
- Aftësitë kompjuterike janë thelbësore.